



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 149/2024
Prishtinë, më 19.11.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramoz Agusholli, Valentina Bunjaku, Rexhepi, anëtarë.

Munguan: Ferat Shala, kryetar, Armend Muja, Abelard Tahiri dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Eva Buqaj – KDI, Bedri Baliu dhe Salih Hoxha – GP LVV, Naim Jakaj – IKD, Festim Gërguri – IKD/Betimi për Drejtësi, dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 5.11.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që në rend dite të shtohet një pikë e re, si pika 4. “*Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut*”, pasi që sot grupi punues e ka dorëzuar raportin me amendamente.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryesueja.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 5.11.2024

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 5.11.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009

Kryesuesja, tha se Komisioni, më 12 mars 2024, ka marrë vendim për të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. Me këtë rast, për realizimin e këtij procesi për monitorim të zbatimit të këtij ligji, Komisioni ka formuar grup punues në përbërje, si në vijim: Driton Hyseni - kryesues, Jeta Statovci, Armend Muja, Valentina Bunjaku – Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Ia kaloj fjalën kryesuesit të këtij grupi, që të paraqesë para Komisionit raportin dhe rekomandimet – urdhëroni z. Hyseni.

Driton Hyseni, tha se ky grup punues ka proceduar me hartimin e planit të punës dhe realizimin e aktiviteteve përmes të cilave kemi pasur për qëllim të shohim se sa po gjen zbatueshmëri ky ligj. Kemi zhvilluar takime me shumicën e ndërmarrjeve publike, takim me një kompani rajonale dhe një kompani lokale, e themeluar së fundmi. Kemi realizuar edhe dëgjim publik me një pjesëmarrje të gjerë të palëve, ku kemi marrë komente të vyera dhe kemi nxjerrë rekomandimet, ku gjithsej janë tetë (8) rekomandime. Ai kërkoi që të votohen këto rekomandime, në mënyrë që të përcillet ky raport për seancën plenare.

Pas debatit, Komisioni me vota unanime, nxori këtë:

REKOMANDIME

- a) *Qeveria (Ministria e Ekonomisë), të ndryshojë dhe të plotësojë Ligjin për ndërmarrjet publike, duke marrë parasysh në veçanti harmonizimin e këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi, në atë mënyrë që sigurojë që të gjitha ligjet të funksionojnë në mënyrë të integruar dhe koherente, duke shmangur konfliktin e mundshëm ligjor.*
- b) *Qeveria (Ministria e Ekonomisë), raportet vjetore të performancës së ndërmarrjeve publike, t'i procedojë në kohë optimale për miratim në Kuvend, ndërsa me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, të përcaktohen saktë afatet për dorëzimin dhe miratimin e raportit të performancës së ndërmarrjeve publike.*
- c) *Qeveria ta shqyrtojë mundësinë që të rishikojë Ligjin për prokurim publik, në raport me ndërmarrjet publike, me qëllim që të adresojë shqetësimet e ndërmarrjeve publike për kufizimet që përmban ligji e të cilat vlerësohet se ndikojnë negativisht në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve publike me sektorin privat. Këto kufizime aktuale paraqesin pengesa të konsiderueshme për realizimin e planeve strategjike dhe operative të ndërmarrjeve publike, duke e bërë më të vështirë për to, të*

konkurrojnë në mënyrë efikase në tregun e hapur.

- d) Ndërmarrjet publike të avancojnë standardin e përgjegjshmërisë dhe transparencës, për të siguruar që të gjitha detyrimet ligjore të përmbushen në mënyrë efektive.*
- e) Të zhvillohen standardet për vlerësimin e performancës së bordeve të ndërmarrjeve publike, nga ana e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, e cila do të përmirësojë qeverisjen e korporatave dhe funksionimin e këtyre ndërmarrjeve.*
- f) Të aprovohen akte nënligjore, të cilat përcaktojnë standardin e matjes së kënaqshmërisë së konsumatorëve. Po ashtu, procedurat përkatëse duhet të specifikojnë metodologjinë e matjes, frekuencën e vlerësimeve, mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe raportimin e rezultateve. Këto udhëzime do të sigurojnë që procesi i matjes të jetë transparent, i besueshëm dhe të reflektojë saktë perceptimet dhe përvojat e konsumatorëve.*
- g) Të bëhet zbatimi i masave afirmative për të synuar barazi gjinore në ndërmarrjet publike. Këto masa duhet të përfshijnë zhvillimin e strategjive të qarta për promovimin e përfaqësimit të barabartë të gjinive, në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe vendimmarrjes.*
- h) Të ngrihen kapacitetet e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të monitorimit dhe zhvillimit të politikave për ndërmarrjet publike.*

Pas 6 (gjashtë) muajve të miratimit të këtyre rekomandimeve nga Kuvendi, Ministria e Ekonomisë të raportojnë në Komision për zbatimin e tyre.

Raporti me rekomandime i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas procedurës, të cilin në emër të Komisionit e paraqet deputeti Driton Hyseni.

4. Shqyrtimi i raportit të punës së grupit punues për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

Kryesuesja, tha se grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ka realizuar takimet e nevojshme me aktorët që preken nga ky ligj, përfshirë edhe organizimin e dëgjimit publik, kjo me qëllim të harmonizimit të ligjit me nevojat e palëve, të cilat e zbatojnë këtë ligj. Nga grupi punues janë nxjerrë 14 amendamente.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se në lidhje me propozimin tim, që neni 15, paragrafi 2 të ndryshohet, si në vijim: “Nëpunësit që kryejnë funksionin e inspektimit, të përcaktuara me këtë ligj, që janë aktualisht në marrëdhënie pune me institucionet lokale dhe qendrore, të transferohen me automatizëm në kuadër të IQMT.” Në vijim, njoftoi se do ta tërheqë, meqenëse ky amendament është përfshirë nga grupi punues.

Pas debatit, Komisioni me vota unanime, nxori këtë:

REKOMANDIM

- 1. Miratohet raporti i grupit punues për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.*
- 2. Raporti i grupit punues, i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas procedurës.*

5.Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Jeta Statovci,

Zëvendëskryetare e Komisionit